



01-2046

	<p align="center">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p align="center">Komuna e Prishtinës Opština Prishtina –Municipality of Prishtina</p>	<p align="center">PRISHTINA</p>
--	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05-391/02-234924/23 dt.20.12.2023, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Mustafë Agushi, Rrahim Ademi, Kismet, Vehbi Ramadani, Fadil, Selami, Remzi Sylja, Naser, Agron, Agim, Xhukolli, Rafet, Shefqet, Behxhet, Nysret, Mehmet Azemi, Muharrem, Bujar, Zijadin, Ruzhdi, Musli, Faton, Milaim, Shefqet dhe Naim Sopi nga Prishtina dhe investitorit “Vllezërit Asllani” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Malush Kosova”, pn, dhe me përfaqësues Qazim Asllanaj nga Gillogoci, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesat: B12/01, B12/02, B12/03, B12/04, B12/05 dhe Aneksi, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “B-3/b_12 të Terësisë “B”, te Planit Rregullues “Muhaxhirët, ne Prishtinë, në rr. “Sali Nivica” dhe “Preng Doqi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 27.05.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve Mustafë Agushi, Rrahim Ademi, Kismet, Vehbi, Ramadani, Fadil, Selami, Remzi Sylja, Naser, Agron, Agim, Xhukolli, Rafet, Shefqet, Behxhet, Nysret, Mehmet Azemi, Muharrem, Bujar, Zijadin, Ruzhdi, Musli, Faton, Milaim, Shefqet dhe Naim Sopi nga Prishtina dhe investitorit “Vllezërit Asllani” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Malush Kosova”, pn, dhe me përfaqësues Qazim Asllanaj nga Gillogoci, sipas kërkesës 05-391/02-234924/23 dt.20.12.2023, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, B12/01 me etazhitet 3B+S+P+14, B12/02 me etazhitet 3B+S+P+14, B12/03 me etazhitet 4B+S+P+13, B12/04 me etazhitet 3B+S+P+12, B12/05 me etazhitet 3B+S+P+12 dhe Aneksi me etazhitet 5B, te ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit” ,05 Nr.351/02-9495/19 dt.20.05.2019, në parcelën kadastrale nr. 10250-1, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10250-1, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “B-3/b_12 te terësisë “B”, te Planit Rregullues “Muhaxhirët, ne Prishtinë në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Sali Nivica” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: Nr. 39, 41, 43, 45, 47, 51, 53, 55, 57, 59, 61, 61/1, 61/2, 61,3, 61/4, 61/5, 61/6, 61/7, 61/8, 61/9, 61/10, 61/11, 61/12, 61/13,dhe rruja “Preng Doqi” Nr. 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33, 35, 37, 41, 43, 45, 47, 49, 51, 53, 55, 57, 61, 63 dhe 65 në Prishtinë, dhe e njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

Ar sy e t i m

Kërkuesit / bashkëpronarët, Mustafë Agushi, Rrahim Ademi, Kismet, Vehbi Ramadani, Fadil, Selami, Remzi Sylja, Naser, Agron, Agim, Xhukolli, Rafet, Shefqet, Behxhet, Nysret, Mehmet Azemi, Muharrem, Bujar, Zijadin, Ruzhdi, Musli, Faton, Milaim, Shefqet dhe Naim Sopi nga Prishtina, me investitor "Vllezerit Asllani" sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Qazim Asllani nga Glligoci, me kërkesën 05-391/02-234924/23 dt.20.12.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B12/01 me etazhitet 3B+S+P+14, B12/02 me etazhitet 3B+S+P+14, B12/03 me etazhitet 4B+S+P+13, B12/04 me etazhitet 3B+S+P+12, B12/05 me etazhitet 3B+S+P+12 dhe Aneksi me etazhitet 5B, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban "B-3/b_12 te terësisë "B", të Planit Rregullues "Muhaxhirët, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10250-1 ZK Prishtinë, ndërtuar sipas "Vendimit për Lejimin e Ndërtimit", 05 Nr.351/02-9495/19 dt.20.05.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-211335/23 dt. 06.12.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3.Inspeksioni i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4.Inspeksioni i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Egzon Elshani/Marigona Asllanaj; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Agon Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Alban Zubaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikëqyrësi Arbnor Haradini; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Agim Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve për mbrojtje nga zjarri , nga mbikëqyrësi Granit Aziri; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Ibrahim Jonuzi me nr. të licensës 105;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm si dhe aneksi mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Bazuar në dëshminë e pronësisë për parcelën ndërtimore nr. 10250-1 ZK Prishtinë, dy nga bashëpronarët, nuk janë më posedues të lejes ndërtimore, pasi që bazuar në aktin noterial "Aktvendim për trashigimi", I përpiluar te noteri Selatin Shahini në Prishtinë, Numri Rendor I LRP 7030/2022, Numri I Referencës

2765/2022, të datës 14.04.2022, dhe në aktin noterial “Kontratë për dhurimin e paluajtshmërive, gjegjësisht pjeses ideale ne paluajtshmëri”, I përpiluar te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë, Numri Rendor I LRP 13082/2018, Numri I Referencës 2775/2018, nga pronaret Rrahim Ademi dhe Muharrem Sopi është bartë pronsia të trashigimtarit e tyre përkatësisht te Burim Ademi dhe Maliq Sopi.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që kompleksi me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-234924/23 DT. 27.05.2024**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



